



## 10 vjet KDI

**Ismet Kryeziu**  
Drejtor Ekzekutiv

**T**ë jesh OJQ, e cila aspiron ide demokratike në një ambient shoqëror, politik e social me progres të ngadalshëm e shpeshherë refuzues në ndërtimin e vlerave të demokracisë, nuk është e lehtë. Është sfidë, por njëherit është nxitje sepse ekzistenca dhe veprimi i ynë nuk është i pa arsye dhe i pa qëllim.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), u themelua para dhjetë vitesh me përkushtimin e një grupi qytetarësh që ishin të gatshëm që përvojat, vizionin dhe ëndrrat e tyre t`i vendosin si kontribut në konsolidimin e vlerave demokratike dhe lirive universale të cilat i pretendon çdo shoqëri e emancipuar.

Në funksion të avansimit të vlerave dhe adresimit të nevojave që ka shoqëria jonë, KDI ka integruar komponente programore, të cilat synojmë t`i vendosim në dispozicion të përmirësimit dhe promovimit të transparencës, pjesëmarrjes qytetare, sigurim të integritetit dhe etikës së institucioneve në luftë kundër korrupsionit, garantim të zgjedhjeve të lira dhe demokratike, promovim të barazisë gjinore në bërjen e politikave dhe marrjen e vendimeve.

Për një dekadë angazhim, KDI nuk do të mundte të ecte përpara dhe të ishte konsistente në qëllimet e saj, pa një staf të përkushtuar, pa partnerët e saj dhe pa qytetarët. Me mijëra gra e burra, të cilët besojnë në vlerat dhe vizionin për një shoqëri të përgjegjshme, jo diskriminuese, transparente me demokraci gjithpërfshirëse u angazhuan përkrah kauzave dhe vlerave që promovon KDI me partnerët.

Këtë 10-vjetor jubilar, KDI e shënon duke qenë pjesë e lëvizjeve globale për një botë më të mirë. Në janar të këtij viti, KDI-ja, zyrtarisht u bë "Chapter" i "Transparency International", teksa në shkurt anëtare e rrjetit të OJQ-ve për monitorimin e zgjedhjeve, ENEMO.

Ne do vazhdojmë me këmbëngulësi të ndjekim misionin tonë duke bërë mobilizimin e grave dhe burrave, duke nxitur energjinë dhe potencialin qytetar në funksion të ndikimit për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës institucionale, politike e shoqërore, ndryshime të cilat janë të dobishme për shoqërinë. Mbështetja dhe besimi juaj vazhdon të mbetet shtytje për t`u angazhuar në ofrimin e vlerave shtesë në zhvillimin, avancimin dhe konsolidimin e demokracisë në vendin tonë.



## Përmbajtja



KDI- udhëheqëse e koalicionit "Demokracia në Veprim" anëtarësohet në ENEMO

DNV vëzhgon zgjedhjet për kryetar të Komunës së Graçanicës

"Shopping" me taksë të qytetarëve

2

Publikohen "Fletënotimet" për Kuvendet e Komunave të regjionit të Prizrenit

KDI, pjesë e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Rahovec

KDI akreditohet si "Chapter" për "Transparency International"

Angazhohen gjashtë hulumtues të jashtëm për Hulumtime Parlamentare

3

Identifikimi i dobësive në sistemin qeverisës sa i përket korrupsionit

Trajnime avokimi për personat me aftësi të kufizuara

Themelohet Grupi Punues për qasje të personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje

4

## KDI- udhëheqëse e koalicionit “Demokracia në Veprim” anëtarësohet në ENEMO



Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë për monitorim të procesit zgjedhor “Demokracia në Veprim”, në shkurt zyrtarisht është anëtarësuar në rrjetin e organizatave monitoruese ENEMO (si anëtar i asociuar).

ENEMO (European Network of Election Monitoring Organizations) është grup i përbërë prej 21 organizatave të shoqërisë civile nga 17 shtete, nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe Evropa Qendrore e Lindore. Këto organizata apartiake janë lidere të grupeve vendëse për monitorim të zgjedhjeve në shtetet e tyre. ENEMO ka vëzhguar gjithsej 110 procese zgjedhore nacionale dhe ka trajnuar më shumë se njëqind mijë vëzhgues të zgjedhjeve. ENEMO përkrahë demokracinë në shtetet e regjionit të OSBE-së, bën vlerësimin e kushteve zgjedhore dhe mjedisit politik dhe ofron raporte apartiake dhe të sakta të vëzhgimit. Misionet vëzhguese të ENEMO-së vlerësojnë procesin zgjedhor duke pas si referencë standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe të lira. Misioni ENEMO, ka vëzhguar disa herë procesin zgjedhor në Kosovë, përfshirë zgjedhjet lokale 2010 dhe ato më 2013.

## DNV vëzhgon zgjedhjet për kryetar të Komunës së Graçanicës

“Demokracia në Veprim”, me rrjetin e organizatave partnere ka vëzhguar procesin zgjedhor në Graçanicë. Zgjedhjet e jashtëzakonshme të 18 janarit, 2015 për të parin e komunës së Graçanicës erdhën si rezultat i dorëheqjes së z. Branimir Stojanović nga posti i kryetarit dhe emërimit të tij në postin e zëvendëskryeministrit të Kosovës. DnV-ja gjatë monitorimit 5 ditësh ka përqendruar aktivitetin në përcjelljen e fushatës, vëzhgimin gjatë ditës së zgjedhjeve, përfshirë këtu procesin e votimit, numërimit dhe edukimin e votuesve.

Qendra e thirrjeve e DnV-së, e funksionalizuar enkas për ditën e zgjedhjeve, ka ndihmuar në grumbullimin e të dhënave nga vëzhguesit në terren lidhur me ecurinë e procesit, daljen e qytetarëve në zgjedhje, parregullsitë eventuale dhe rezultatin preliminar të zgjedhjeve. Këto të dhëna i janë komunikuar publikut gjatë gjithë ditës nëpërmjet komunikatave për shtyp.

Zgjedhjet e 18 janarit dhe fushata zgjedhore, ndonëse e zbehtë për nga oferta politike, u mbajtën në atmosferë të qetë, duke iu përmbajtur



standardeve të zgjedhjeve të lira e demokratike.

Dalja e votuesve në këto zgjedhje krahasuar me zgjedhjet e kaluara komunale ka pësuar rënie të theksuar, nga 54.6% (2013) në 37.3% (2015). DNV publikoi rezultatet preliminare një orë pas përfundimit të procesit të votimit, ndërsa kryetar komune u zgjodh kandidati nga “Gradjanska Inicijativa Srpska”, z. Vladeta Kostić.

## “Shopping” me taksa të qytetarëve

Tre tenderët më specifikë të komunës së Prizrenit (Mirëmbajtja e rrugëve, furnizimi me naftë dhe tenderi për ndërtimin e një rruge me kubëza të betonit) u monitoruan dhe analizuan në kuadër të projektit për monitorim të prokurimit publik, që KDI/Transparency International Kosova (TIK) implementon në pesë komuna. Të gjeturat u publikuan përmes raportit i cili u shpalo në një tryezë në janar të 2015 dhe ndër tjerash u kërkua që t'i kushtohet vëmendje të shtuar mbikëqyrjes së prokurimit nga Kuvendi Komunal si dhe Prokuroia e Shtetit me theks të veçantë formës së menaxhimit financiar, mashtrimit dhe dyshimeve për korrupsion.

KDI/TIK synon që përmes këtyre analizave të ndihmojë komunat të marrin vlerën për parane publike të shpenzuar dhe për të evidentuar barrierat administrative për operatorët ekonomikë të cilat dobësojnë konkurrencën e drejtë. Gjithashtu synohet informimi qytetarët me formën se si komuna e tyre administrojnë buxhetin e besuar dhe cilat kompani kanë përfituar kontrata publike nga komunat.

## Publikohen “Fletënotimet” për Kuvendet e Komunave të regionit të Prizrenit

Gjithsejt 176 deputetë të gjashtë Kuvendeve Komunale të regionit të Prizrenit janë notuar dhe vlerësuar për punën e tyre individuale për gjashtë mujorin e dytë të 2014. Për më tepër është analizuar edhe puna e subjekteve politike të përfaqësuara në këto Kuvende. Përmes këtyre fletënotimeve, KDI vazhdon të informojë në mënyrë të paanshme dhe objektive qytetarët për performancën e të zgjedhurve të tyre. Trendi i diskutimeve, inicimi apo amandamentimi i legjislacionit dhe çështjeve me interes për qytetarët, pyetjet parlamentare, gjuha jo-parlamentare etj janë disa nga shtyllat mbi të cilat bëhet vlerësimi individual i deputetëve dhe subjekteve politike.

Komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Dragash dhe Mamushë



## KDI, pjesë e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Rahovec



Në kuadër të zgjedhjeve për anëtarët dhe kryetarët e Këshillave Lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të komunës së Rahovecit, KDI si pjesë e komisionit komunal ka dhënë kontribut të vlefshëm në përgatitjen teknike për mbarëvajtjen e këtij procesi.

Me zgjedhjen e këtyre strukturave, qytetarët e Rahovecit do të kenë mundësi të angazhohen në mënyrë aktive në politikë-bërjen komunale. Përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në këto këshilla ata do të mund t'i artikulojnë kërkesat dhe shqetësimet pranë autoriteteve komunale, ndërsa ky mekanizëm do të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet tyre dhe vendimmarrësve në hartimin dhe implementimin e politikave publike. Procesi i zgjedhjeve pritet të përfundojë në mars të 2015.

## Angazhohen gjashtë hulumtues të jashtëm për Hulumtime Parlamentare

Në kuadër të Projektit Përkrahje për Hulumtime Parlamentare dhe Përfshirje Qytetare, KDI pranoi kërkesa për gjashtë hulumtime parlamentare nga komisione të ndryshme për 6 ligje, përfshirë atë për Avokatin e Popullit, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Kundërvajtje, për Pyjet dhe për Ushqimin. Qëllimi i këtij projekti është që Kuvendi të miratojë ligje sa më cilësore dhe të zbatueshme, për të cilat fillimisht bëhen hulumtime nga institutet hulumtuese dhe hulumtues tjerë të pavarur të fushave të ndryshme. Edhe vetë Kryetarët e Komisioneve pajtohen që ligjet do të përfitonin nga një hulumtim paraprak nga jashtë. KDI vazhdimisht bën thirrje që Kuvendi të shqyrtojë me kujdes projekt-ligjet dhe t'ua mundësojë trupave të saj të kërkojnë hulumtime apo informata shtesë për këto projekt-ligje. Në këtë kuadër, është ndërtuar edhe një databazë ekspertësh dhe institutesh të fushave të ndryshme e që është në dispozicion të komisioneve parlamentare. Databaza online mbetet ende e hapur për regjistrim të instituteve hulumtuese: [www.kdi-kosova.org/hulumtime\\_parlamentare](http://www.kdi-kosova.org/hulumtime_parlamentare).



**TRANSPARENCY  
INTERNATIONAL  
KOSOVA**

## KDI akreditohet si “Chapter” për “Transparency International”

Instituti Demokratik i Kosovës nga 14 janari i është dhënë e drejta e përfaqësimit të organizatës Transparency International (TI) për Kosovë. KDI-ja si përfaqësues i akredituar i TI-së në Kosovë, tashmë është pjesë e një lëvizje globale që përfaqëson më shumë se 100 shtete në tërë botën. Nëpërmjet një bashkëpunimi të fuqishëm që ka evoluar që më shumë se 6 vite, KDI-ja nëpërmjet të qenit “Chapter” i TI-së, do të vazhdojë të kontribuojë në vizionin e TI-së në zhvillimin e një bote më të mirë në të cilën qeveria, bizneset, shoqëria civile dhe jeta e përditshme e qytetarëve është e lirë nga korrupsioni.



## Identifikimi i dobësive në sistemin qeverisës sa i përket korrupsionit



Janë tre hapa për të zgjidhur një problem: identifikimi i problemit, gjetja e zgjidhjeve alternative, përzgjedhja dhe zbatimi i një zgjedhje.

Analiza e Sistemit të Integritetit Kombëtar (SIK) synon që të kontribuojë pikërisht në identifikimin dhe ofrimin e zgjidhjeve. Në këtë drejtim KDI-ja ka filluar të bëjë vlerësimin e 'shtyllave' kryesore në sistemin qeverisës, si në drejtim të rreziqeve të brendshme sa i përket korrupsionit gjithashtu edhe në kontributin e tyre në luftimin e korrupsionit në shoqëri. Ky vlerësim i ofron shoqërisë civile dhe qeverisë një pasqyrë të dobësive në sistemet e qeverisjes dhe ndihmon që të vendosen prioritetet për reforma.

Pas përfundimit të vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar, KDI-ja do të bashkëpunojë me qeverinë dhe partnerë të ndryshëm për të përmirësuar anomalitë. Gjetjet preliminare kanë rezultuar me një seri të dobësive të cilat kërkojnë reforma strukturale të institucioneve që luftojnë korrupsionin. Dobësitë më të theksuara në sistemin e integritetit kombëtar janë evidentuar në sistemin e prokurimit publik, gjyqësor e prokurori, si dhe parregullsi në financimin e partive politike.



### Trajnime avokimi për personat me aftësi të kufizuara

Për ta ngritur zërin dhe për të bërë ndryshimin duhen aftësi të mira avokimi. DnV-ja ka organizuar sesione trajnimi për 145 persona me aftësi të kufizuara në 5 rajone si Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë. Anëtarë të organizatave të personave me aftësi të kufizuara u trajnuan se si praktikisht të zhvillojnë fushata të suksesshme të avokimit dhe si t'i përdoren mediat e lira për të promovuar çështjet e tyre. Për më tepër ata u mësuan se si të shkruajnë një komunikatë për shtyp, si të organizojnë një konferencë për media dhe se si të hartojnë plane të veprimit.

### Themelohet Grupi Punues për qasje të personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje

Angazhimi për herë të parë i mbi 200 vëzhguesve me aftësi të kufizuara për të vëzhguar zgjedhjet nacionale të 2014-të ishte një hap i rëndësishëm për të siguruar një proces zgjedhor gjithëpërfshirës. Avancimi i kornizës ligjore dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike janë tema në të cilat Demokracia në Veprim dhe HandiKOS, në bashkëpunim edhe me organizatat tjera që trajtojnë aftësinë e kufizuara kanë vazhduar t'i promovojnë dhe jetësojnë. Në kuadër të kësaj,



është themeluar edhe Grupi Punues për Qasje Elektorale që përbëhet nga përfaqësues



të: OSHC/PAK (Organizatave të Shoqërisë Civile të Personave me Aftësi të Kufizuara), Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, partive politike dhe institucioneve shtetërore. GPQE ka hartuar një strategji me anë të së cilës synon t'i adresojë problemet dhe sfidat që e ballafaqojnë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara për të përmirësuar kushtet dhe ambientin që do të ndikoj drejtpërdrejt në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike dhe politike, në veçanti në procesin zgjedhor. Strategjia pritet të implementohet nga viti 2015 deri në vjeshtën e vitit 2017 kur edhe do të kemi procesin e ardhshëm zgjedhor.